



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
MINISTRI

Nr. prot. 5889

datë 12/06/ 2019

URDHËR

Nr. 243 datë 12 06 2019

**“PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.197, DATË 09.10.2014 “PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË MARRËVESHJES PËR KRYERJEN E Oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (e ndryshuar); ligjit nr.9000, datë 30.1.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e opionencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin me nr.197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e opionencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, të bëhen ndryshimet si vijon:
  - a. Pika 1, ndryshon me përmbajtjen si vijon: “*Për të gjitha projektet (objektet) publike të veprave të ndërtimit, për të cilat kryerja e opionencës teknike është e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi, opionenca teknike të kryhet nga Instituti i Ndërtimit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës*”;
  - b. Në pikën 2 togfjalëshi “*Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit*” zëvendësohet me togfjalëshin “*Universiteti Politeknik i Tiranës*”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR



Belinda Balluku